

PERCEPTIMI I KLSH-SË NËN FRYMËN E INOVACIONIT¹

nga Evis Çela

Shoqëria jonë po ndryshon me ritme të shpejta. Vitet e fundit kanë qenë dëshmitarë të zhvillimit marramendës të teknologjisë së informacionit, internetit dhe metodave të punës gjithnjë e më tepër inovative. Këto zvilleme kanë sjellë ndikimin e tyre në politikën, qeverisjen, shoqërinë dhe demokracinë e shteteve.

Ashtu si çdo sektor tjetër në shoqëri apo ekonomi, sektori publik dhe institucionet supreme të auditimit si pjesë e tij, përballen me presionin e inovacionit dhe kryerjes së punëve në mënyrë të ndryshme e inovative, duke synuar arritjen e rezultateve më të mira si dhe përmbushjen e pritshmërive të qytetarëve dhe grupeve të tyre të interesit.

Inovacioni është një nga ato fjalët e përdorura aq shpesh dhe për të cilën të gjithë bien dakord se na duhet "më shumë". Në kuptimin më të thjeshtë të tij, ai përkufizohet si prezantimi i diçkaje të re apo të ndryshme nga ajo e ofruar më parë. Shpesh inovacioni si koncept barazohet me ndryshimin. Megjithatë, perceptimi i tij nuk është i njëjtë – ajo çfarë është e re për dikë, mund të konsiderohet e vjetër nga dikush tjetër. Por, megjithëse përkufizimi dhe klasifikimi i inovacionit karakterizohet nga subjektivizmi, të gjithë bien dakord për domosdoshmërinë e tij në sektorin publik dhe si pasojë edhe në Institucionet Supreme të Auditimit.

Ekzistojnë dy qasje të kundërta për sa i takon inovacionit: një qasje argumenton se inovacioni duhet të zhvillohet duke mbajtur parasysh impaktin tek përdoruesit apo palët e interesit, ndërsa qasja tjetër argumenton se inovacioni ka të bëjë me ide që mund të gjenerohen vetëm nga njerëz

vizionarë, të cilët mbështeten më tepër tek vizioni i tyre se sa tek inputi që marrin nga jashtë. Në vitin 1908, kur Henry Ford prodhoi linjën e re të montimit e cila lejoi krijimin e automjeteve me kosto të ulët duke revolucionarizuar Amerikën e duke bërë të mundur që automjeti të mos ishte vetëm ekskluzivitet i të pasurve, ai u shpreh “Po të kisha pyetur njerëzit se çfarë kërkonin, ata me siguri do të më kishin thënë kuaj të shpejtë”. Steve Jobs kur prodhoi Iphon-in e parë, duke ndryshuar mënyrën e perceptimit të një telefoni celular në një “smartphone” multifunksional, ishte i sigurt se po të kishte pyetur njerëzit nëse ata donin një telefon prej xhami i cili mund të thyhej sa herë binte në tokë, ata do të ishin përgjigjur “jo”. Edhe pse mund të perceptohet me vështirësi apo ndoshta edhe të refuzohet, inovacioni duhet të nxitet, ushqehet dhe promovohet, pasi përfitimet që mund të vijnë prej tij shpesh tejkalojnë çdo parashikim.

Një mënyrë më e drejtë për të menduar rreth inovacionit është që ai ka të bëjë me sjelljen në jetë të diçkaje të re dhe që ka një vlerë apo dobi të caktuar. Inovacioni ndodh në disa nivele, që nga përmirësimet më modeste të një produkti apo procesi ekzistues e deri tek ato më të rëndësishme e thelbësore.

Modeli teorik më i vlefshëm në këtë drejtim, është ai i zhvilluar nga John Bessant dhe Joe Tidd. Modeli ka në qendër të tij katër elementë të cilët janë pjesë e çdo organizate: produkti, proceset, pozicionimi dhe parimet. Këto elementë janë të ndërlidhur me njëri tjetrin dhe shërbejnë si pikënisje për inovacionin. Ky model ngrihet mbi hipotezën që inovacioni i suksesshëm është thelbësor për të nxitur ndryshimet pozitive dhe thekson se janë katër kategori të gjëra ku mund të ndodhin këto ndryshime:

“Inovacioni i produktit” – ka të bëjë me ndryshimet në produktin apo shërbimet që ofrohen nga një organizatë. Kjo është forma e inovacionit që perceptohet më lehtë-ndryshime në atë çka i ofrohet përdoruesve finalë. Në rastin e Institucioneve Supreme të Auditimit mund të flasim për raportet e auditimit si produkti kryesor i prodhuar prej tyre, por edhe për procesin e këshillimit të ofruar. Kontrolli i Lartë i shtetit ka bërë disa hapa para në këtë drejtim, duke synuar publikimin e raporteve të auditimit sa më koncize e të sakta. Gjithashtu, krijimi i Departamentit të Auditimit një vit më parë, ka sjellë inpute të rëndësishme për krijimin e “produktit të këshillimit” që institucioni ofron.

“Inovacioni i proceseve” – Ndryshime në mënyrën se si krijohen, prodhohen apo ofrohen produktet dhe shërbimet. Në kuadrin e Institucioneve të Auditimit, mund të flasim për veprimtarinë apo procesin e auditimit në të gjithë hapat e tij. Proceset e auditimit në Kontrollin e Lartë të Shtetit janë ristrukturuar, përmirësuar dhe kanë tashmë një frymëmarrje të re.

“Inovacioni i pozicionimit” – ndryshime në kontekstin në të cilin prodhohen apo konceptohen produktet dhe shërbimet. Kjo formë inovacioni ka të bëjë me ri-pozicionimin e perceptimit të një produkti apo procesi në një ambient specifik, pra me ndryshimet që ndodhin në mënyrën se si perceptohen produktet apo proceset. Në këtë kuadër, Kontrolli i Lartë i Shtetit ka ndryshuar mënyrën se si duhet të perceptohet në auditim, duke i konsideruar të audituarit jo vetëm si “kundërshtarë”, por edhe si partnerë. Gjithashtu ky institucion është afruar me qytetarët dhe ka mbajtur në konsideratë ndjeshmërinë e tyre për çështje të caktuara.

“Inovacioni i parimeve” – ka të bëjë me ndryshime në modelet e të menduarit që i japin formën një organizate. Ky lloj inovacioni ka të bëjë me ri-konceptimin e parimeve kryesore të një organizate apo një sektori në tërësi, proces i cili është në vazhdimësi edhe në Kontrollin e Lartë të Shtetit.

Por jo gjithmonë inovacioni është i mirëpritur. Shumë shpesh ai ndeshet me pengesa që e bëjnë të pamundur zhvillimin dhe përhapjen e tij, të cilat mund të tejkalohen në radhë të parë duke kuptuar impaktin që sjell inovacioni dhe më tej duke ndryshuar mendësinë e institucionit apo shoqërisë në tërësi.

Duke qenë i ndërgjegjshëm për rëndësinë e inovacionit, gjithnjë e më tepër Kontrolli i Lartë i Shtetit po kërkon qasje të reja dhe inovative, për të ndjekur ritmin e kohës në të cilën jetojmë, kohës së zhvillimeve të shpejta teknologjike, shoqërore, ekonomike dhe politike. Në këtë kuadër, vitin e fundit janë implementuar disa praktika inovative.

Kontrolli i Lartë i Shtetit ka ndërtuar marrëdhënie pune e bashkëpunimi me tetë Organizata të Shoqërisë Civile, duke synuar shkëmbimin e informacioneve dhe përforcimin e funksioneve të tij në lidhje me transparencën dhe përgjegjshmërinë. Organizatat e shoqërisë civile kanë shërbyer për të kanalizuar pjesëmarrjen e qytetarëve duke u bërë zëri përcues i tyre dhe duke propozuar tema konkrete për auditim. Profesionistët e këtyre organizatave kanë qenë gjithashtu pjesë e grupeve të auditimit, ku kanë sjellë ekspertizën e tyre në ato fusha për të cilat janë të profilizuara. Gjithashtu këto ekspertë janë përfshirë si lektorë në trajnimet e stafit të KLSH-së, me qëllim rritjen e kapaciteteve audituese të tij.

Gjithashtu, Kontrolli i Lartë i Shtetit ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me tre shoqata profesionistësh, kryesisht në fushën e kontabilitetit. Ky bashkëpunim ka sjellë ndihmesën e tij në rritjen e kapaciteteve dhe njohurive

profesionale të stafit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, nëpërmjet trajnimeve dhe konsultimeve me ekspertët e tyre. Profesionistët e këtyre organizatave, kanë sjellë një ndihmë konkrete me traditat, vlerat dhe ekspertizën e tyre të kualifikuar në fushën e kontabilitetit dhe auditimit të fondeve publike.

Si fryt i këtij bashkëpunimi, për herë të parë nga Kontrolli i Lartë i Shtetit u organizua këtë vit një konferencë shkencore, duke synuar që nëpërmjet kërkimit të aplikuar shkencor të nxitet progresin dhe efektiviteti më i lartë i institucionit. Bashkëpunimi me shoqatat e profesionistëve por edhe me SAI-t partnere të Polonisë, Turqisë, Suedisë etj. solli një vlerë të shtuar për këtë konferencë, ku ata kontribuan nëpërmjet artikujve të tyre.

Një tjetër praktikë inovative e implementuar, ka qenë prania e lartë e audituesve në median e shkruar. Gjatë vitit të fundit, 33 drejtues dhe auditues të lartë kanë shkruar më shumë se 100 artikuj mbi aspektet teorike apo praktike të auditimit, kanë sjellë përvojën e tyre mbi çështje të caktuara të ndjeshme për palët e interesit si dhe kanë informuar publikun mbi praktikatat më të mira të auditimit të jashtëm. Nëpërmjet kësaj veprimtarie, Kontrolli i Lartë i Shtetit synon të ndërtojë një marrëdhënie të re besimi me qytetarët si dhe të promovojë transparencën dhe përgjegjshmërinë.

Gjithashtu, një nga risitë më të fundit e aplikuar nga Institucionet Supreme të Auditimit, është “*open spending*”, pra publikimit të transaksioneve financiare për publikun, duke promovuar kështu transparencën dhe duke nxitur nëpërmjet shembullit të tyre edhe institucionet e tjera publike të bëjnë të njëjtën gjë. Në këtë drejtim, Kontrolli i Lartë i Shtetit ka kërkuar nga Kuvendi auditimin e llogarive të tij, në mbështetje të nenit 78, pika 1 të Kushtetutës, të nenit 55, pika 1 të Rregullores së Kuvendit, dhe të ligjit nr. 8270, datë 23.12.1997, “Për Kontrollin e Lartë të Shtetit”, të ndryshuar,

auditim i cili është kryer për herë të fundit në vitin 2001. Kjo kërkesë është miratuar nga Kuvendi dhe pritet të nisë auditimi i pavarur i llogarive vjetore, duke nxitur e promovuar kështu transparencën e këtij institucioni.

ⁱ Botuar në Gazetën “Ekonomia” dt. 25 Dhjetor 2013